



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/86

Datë: 08.10.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 08 tetor 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja 84 dhe 85 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/86

Datë: 08.10.2009

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4 dhe nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1, nenit 8, paragrafi 5, të Ligjit Nr. 03/L-139, Për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, si dhe nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës Nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 08 tetor 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa për shpronësim në pjesën e ngastrave kadastrale të pronave të paluajtshme për 13 (trembëdhjetë) zona kadastrale të segmentit Vermicë - Prizren, nëpër të cilat do të kalojë (ndërtohet) Autostrada Vermicë-Merdare.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të përcaktohet sipas kategorive përkatëse nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave e cila do të mbështetet nga Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit dhe Kuvendi Komunal i Prizrenit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit dhe Kuvendi Komunal i Prizrenit.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/86
Datë: 08.10.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 08 tetor 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet ndarja e mjeteve në shumën prej 70.235.00 (shtatëdhjetëmijë e dyqindetridhjetepesë) euro për shlyerjen e detyrimeve të mbetura nga viti 2006, ndaj punëkryesve të kontraktuar për mbylljen e kampit të romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve në Mitrovicë.
2. Mjetet për pagesën e detyrimeve të mbetura sigurohen nga rezervat e Ministrit të Ekonomisë dhe Financave.
3. Për zbatimin e këtij vendim ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/86

Datë: 08.10.2009


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, dhe në mbështetje të nenit 12, paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2008, mbi Funksonimin e Fondit për Mbështetjen e Mediave Minoritare, Multietnike dhe Grupeve Tjera të Veçanta, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 08 tetor 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet lista e medimeve përfituese të granteve, e rekomanduar nga Komisioni për Menaxhimin e Fondit për Mbështetjen e Mediave Minoritare, Multietnike dhe Grupeve Tjera të Veçanta, sipas Rregullores Nr. 01/2008, mbi Funksonimin e Fondit për Mbështetjen e Mediave Minoritare, Multietnike dhe Grupeve Tjera të Veçanta.
2. Listës së rekomanduar i shtohen edhe mediumet në gjuhën turke; Radio "Kent FM", e cila përfiton grantin e kërkuar në shumën prej 9.771 (nëntëmijeshatëqind e shtatëdhjetenjë) euro, dhe "Kosova Haber", e cila përfiton grantin në shumën prej 9.800 (nëntëmijetëqind) euro.
3. Grantet financiare do të ndahen nga Fondi për Mbështetjen e Mediave Minoritare, Multietnike dhe Grupeve Tjera të Veçanta, nga 5% e mjeteve të grumbulluar për parapagimin e RTK-ës, sipas Ligjit Nr. 02/L-47 për radio Televizioni e Kosovës, neni 20, pika 11.
4. Mënyra e shfrytëzimit, afatet e pagesës së grantit, raportimi i shpenzimit të grantit dhe monitorimi i shpenzimit të granteve do të rregullohen me marrëveshjen për shfrytëzimin e granteve, që do të nënshkruhet nga Komisioni për Menaxhimin e Fondit dhe mediumet përfituese.
5. Obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimit i bashkëngjitet lista e medimeve përfituese të granteve.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Lista e medimeve përfituese të granteve nga Fondi për Mbështetjen e Mediave Minoritare, Multietnike dhe Grupeve Tjera të Veçanta:

<i>Mediumi:</i>	<i>Buxheti i aprovuar:</i>
1. Televizija Herc	14.850 euro
2. Radio Televizija "MIR" Leposaviq	12.996 euro
3. Kontakt plus Radio Mitrovicë	10.000 euro
4. Kosovska Medijska Asociacija	10.000 euro
5. TV Puls - Shillovo - Gjilan	7.140 euro
6. Radio KIM - Çagllavicë - Prishtinë	10.000 euro
7. Produkcija New Press- Qagllavica - Prishtinë	8.800 euro
8. Udruženje Bošnjaka 'Kosovski Avazi' ALEM	15.000 euro
9. Radio Gora - Dragash	10.000 euro
10. Radio "ASTRA"	10.000 euro
11. Radio Premiera, "D-press" dhe "CDKD" nga Kamenica	10.000 euro
12. Radio K - Fushë Kosovë	9.840 euro
13. Radio Kamenica - Multietnike	6.948 euro
14. Radio Romano Avazo, OJQ "Durmish Asllano"	10,000 euro
15. Syri ynë	14,975 euro
16. Radio "Kent FM",	9,771 euro
17. Gazeta elektronike "Kosova Haber",	9.800 euro

Gjithsej shtatëmbëdhjetë (17) medime përfituese, me një total të buxhetit të përgjithshëm të granteve prej 180,120 (njëqind e tetëdhjetë mijë e njëqind e njëzet) euro.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/86

Datë: 08.10.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 08 tetor 2009, mori

V E N D I M

1. Në Strategjinë Legjislative për vitin 2009 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të përfshihet edhe:
 - a) Projektligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.
2. Ngarkohet Zyra për Shërbimet e Ndihmës Juridike në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë